Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Bujar Kuçi	**20.08.2026**	**28.08.2026**	**2026/0595**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 12.08.2026, OE "LAB-OIL SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2026/0595, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë Operatori Ekonomik: "Petrol Company-SH.P.K."-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me karburante" me nr. të prokurimit: "201/26300-26-2068-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Agjencia Qendrore e Prokurimit.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontrates: furnizim, vlera e parashikuar e kontrates:

Lot 4 – Furnizim me karburante për nxehmje/gjenerator dhe rezerva për nevojat e institucioneve publike të Nivelit Qendror - 3,700,000.00€

Lot 9 – Furnizim me karburante për Rajonin e Mitrovicës (Nivel Lokal) -710,000.00€

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Aktiviteti i prokurimit me titull: "Furnizim me karburante" , Nr i Prokurimit: 201/26300-26-2068-1-1-1

Grupi i OE "LAB OIL" Sh.p.k & N.T "Fer Petroll" Sh.p.k jan palë me interes në aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me karburante", ka aplikuar ne dy Lote
Lote të kontestuara:
• Lot 4 – Furnizim me karburant për nxemje, gjenerator dhe rezerva për nevojat e institucioneve publike në nivel qendror
Vlera e ofertës së Grupit të OE "LAB OIL" Sh.p.k. & N.T "Fer Petroll" Sh.p.k.: 3,588,731.56 €
• Lot 9 – Furnizim me karburant për Rajonin e Mitrovicës (Nivel Lokal)
Vlera e ofertës së Grupit të OE "LAB OIL" Sh.p.k. & N.T "Fer Petroll" Sh.p.k.: 696,725.12 €
Në bazë të ofertave financiare të dorëzuara në platformën elektronike e-Prokurimi, Grupi i OE "LAB OIL" Sh.p.k & N.T "Fer Petroll" Sh.p.k ka qenë ofertuesi me çmimin më të ulët ekonomikisht për të dy lotet e lartcekura.
Përkundër faktit se oferta jonë ka qenë më çmim me te lirë dhe ka pas parasysh përdorimin më efikas të mjeteve publike, Autoriteti Kontraktues, me datë 21.07.2026, përmes sistemit elektronik e-Prokurimi, na ka njoftuar me: Njoftimin mbi Vendimin duke na eliminuar si Grup i OE i papërgjegjshëm, me arsyetimin se nuk kemi përmbushur kërkesën e Dosjes së Tenderit.

ARSYETIMI I ELIMINIMIT TË OFERTËS SONË Grupi i OE "LAB OIL" Sh.p.k & N.T "Fer Petroll" Sh.p.k
Arsyeja e eliminimit sipas AK-AQP-së, ka qenë mosplotësimi i Kërkesës 4: "Garancion apo autorizim apo konfirmim nga rafineria/prodhuesi."

Eevidencës 4: "Garancion apo autorizim apo konfirmim nga prodhuesi – rafineria, që garanton se do të furnizojë për kontratën/lotin e specifikuar në të cilin ofertoni – origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur."
Pas tërheqjes dhe analizimit të dokumentacionit të tenderit në platformën elektronike e-Prokurimi, kemi konstatuar se vendimmarrja e Autoritetit Kontraktues është në kundërshtim me dispozitat e LPP-së, Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, Rregullores Nr. 002/2024, si dhe me kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit.
Megjithatë, pas shqyrtimit të dokumentacionit të Operatorit Ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës, kemi konstatuar se dokumentet e paraqitura nga ky operator nuk përmbushin të njëjtën kërkesë të Dosjes së Tenderit.
Përkundër kësaj, Autoriteti Kontraktues e ka konsideruar ofertën e tij të përgjegjshme dhe e ka rekomanduar për dhënie të kontratës, duke përdorur standarde të ndryshme gjatë procesit të vlerësimit.

KUNDËRSHTIMI VENDIMIT MBI NJOFTIMIN E AK AQP-së

Kundërshtojmë në tërësi këtë vendim, pasi konsiderojmë se i njëjti është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, si dhe me dispozitat e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, si dhe me parimet themelore të prokurimit publik, përkatësisht parimin e trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit, proporcionalitetit, transparencës dhe përdorimit efikas të fondeve publike.

Nga arsyetimi i dhënë nga Autoriteti Kontraktues rezulton se oferta jonë është eliminuar me arsyetimin se mungon Garancioni/Autorizimi nga prodhuesi. Mirëpo, pas analizimit të dokumentacionit të procedurës, kemi konstatuar se Autoriteti Kontraktues – AQP nuk ka aplikuar të njëjtin standard vlerësimi ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë, por ka përdorur standarde të ndryshme dhe të pabarabarta gjatë shqyrtimit të ofertave.

Në rastin tonë, Autoriteti Kontraktues ka konsideruar se dokumentacioni i paraqitur nuk është i mjaftueshëm për përmbushjen e kërkesës së Dosjes së Tenderit, ndërsa në anën tjetër ka rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik "Petrol Company" Sh.P.K., ndonëse dokumenti i paraqitur nga ky operator nuk përbën garancion apo autorizim në kuptimin e kërkesës së Dosjes së Tenderit.

Konkretisht, operatori ekonomik "Petrol Company" Sh.P.K. ka paraqitur dokumentin e lëshuar nga OKTA AD – Shkup, me titull "Supply Contract with Manufacturer". Nga përmbajtja e këtij dokumenti rezulton se bëhet fjalë për një marrëveshje furnizimi ndërmjet palëve dhe jo për një Garancion të prodhuesit apo Autorizim të prodhuesit, siç është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues në dokumentet e tenderit.

Ky dokument nuk përmban një deklarim të qartë të prodhuesit për autorizimin e operatorit ekonomik për këtë procedurë prokurimi dhe nuk ofron garanci të drejtpërdrejtë lidhur me përgjegjësinë e prodhuesit për furnizimin, cilësinë dhe vazhdimësinë e furnizimit gjatë realizimit të kontratës.

Në anën tjetër, Grupi i Operatorëve Ekonomik "LAB OIL" Sh.p.k. & N.T "Fer Petroll" Sh.p.k. ka paraqitur dokumentacion që dëshmon marrëdhënie të rregullt furnizimi përmes marrëveshjes me kompaninë "Kastrati Group" SH.A., e cila është distributor i autorizuar i prodhuesit OMW Supply & Trading Limited, me seli në Angli. Ky dokumentacion siguron

Autoritetin Kontraktues se ekziston një zinxhir i furnizimit dhe se mundësohet furnizimi i sigurt, i vazhdueshëm dhe sipas kërkesave të kontratës.

Prandaj, edhe nëse Autoriteti Kontraktues ka pasur paqartësi lidhur me interpretimin e dokumenteve të paraqitura nga Grupi ynë i Operatorëve Ekonomikë, ai ka qenë i obliguar që të zbatojë të njëjtin standard edhe ndaj operatorit ekonomik të rekomanduar. Nuk është e lejueshme që një operator ekonomik të eliminohet për shkak të një interpretimi të caktuar të dokumentacionit, ndërsa një operator tjetër të pranohet me dokumentacion që në thelb nuk e përmbush kërkesën e njëjtë.

Po ashtu, bie në kundërshtim me nenin 56 të LPP-së, pasi vlerësimi dhe eliminimi i ofertave duhet të bëhet vetëm mbi bazën e kërkesave të përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit. Autoriteti Kontraktues nuk mund të interpretojë ose të krijojë kërkesa të reja gjatë fazës së vlerësimit, të cilat nuk kanë qenë të përcaktuara qartë në dokumentet e tenderit.

Në këtë rast, Autoriteti Kontraktues ka aplikuar një qasje më të ashpër ndaj ofertës sonë, ndërsa ka pranuar dokumentacion më pak të përcaktuar nga operatori ekonomik i rekomanduar, duke cenuar kështu parimin e konkurrencës së drejtë dhe të trajtimit të barabartë.

Gjithashtu, Autoriteti Kontraktues ka qenë i obliguar të ketë në konsideratë faktin se oferta jonë është oferta ekonomikisht më e favorshme për Lotin 4 dhe Lotin 9, me një diferencë të përgjithshme prej 122,099.47 € më të ulët krahasuar me ofertën e operatorit ekonomik të rekomanduar.

Duke eliminuar ofertën tonë, e cila përveç se është ekonomikisht më e favorshme, ka paraqitur dokumentacion që garanton furnizimin për realizimin e kontratës, Autoriteti Kontraktues ka rrezikuar cenimin e parimit të përdorimit racional dhe efikas të fondeve publike.

Në kuptim të dispozitave të nenit 40 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, përkatësisht paragrafëve 40.2, 40.6, 40.12 dhe 40.13, Autoriteti Kontraktues ka obligim që ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave ta bëjë në mënyrë objektive, transparente dhe duke zbatuar kriteret e publikuara në mënyrë të njëjtë për të gjithë operatorët ekonomikë.

Bazuar në të gjitha këto fakte dhe argumente juridike, konsiderojmë se vendimi i Autoritetit Kontraktues për eliminimin e ofertës sonë dhe rekomandimin e operatorit ekonomik "Petroll Company" Sh.P.K. është i pabazuar në dispozitat ligjore dhe në kërkesat e Dosjes së Tenderit.

DËMI EKONOMIK DHE CENIMI I PARIMIT TË EKONOMICITETIT

Grupi i OE "LAB OIL" Sh.p.k. & N.T "Fer Petroll" Sh.p.k. ka paraqitur ofertën me çmimin më të lirë në krahasim me Operatorin Ekonomik "Petrol Company" SH.P.K., i rekomanduar për shpërblim me kontratë.

Dallimi financiar ndërmjet ofertave është:

Lot 4. Diferenca ndërmjet ofertës së Grupit të OE: "LAB OIL" Sh.p.k. & N.T "Fer Petroll" Sh.p.k. dhe ofertës së OE:"Petrol Company" H.P.K. është: 109,032.00 € më e lartë oferta e OE "Petrol Company" SH.P.K.

Lot 9. Diferenca ndërmjet ofertës së Grupit të OE:"LAB OIL" Sh.p.k. & N.T "Fer Petroll" Sh.p.k. dhe ofertës së OE: "Petrol Company" SH.P.K. është: 13,067.47 € më e lartë oferta e OE "Petrol Company" SH.P.K.

KËRKESA E KONTSTUAR NË DOSJEN E TENDERIT

Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar kërkesën si vijon:
Kërkesa 4: "Garancion apo autorizim apo konfirmim nga rafineria/prodhuesi."
Evidenca 4: "Garancion apo autorizim apo konfirmim nga prodhuesi – rafineria, që garanton se do të furnizojë për kontratën/lotin e specifikuar në të cilin ofertoni – origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur."
Kjo kërkesë është vendosur nga vetë Autoriteti Kontraktues me qëllim të sigurimit se operatori ekonomik do të ketë mbështetje reale nga prodhuesi/rafineria dhe se furnizimi për kontratën përkatëse do të jetë i garantuar.
Prandaj kjo kërkesë nuk ka qenë thjesht dokument formal, por kriter substancial që lidhet drejtpërdrejt me realizimin e kontratës

ANALIZA E DOKUMENTACIONIT TË PARAQITUR NGA OE I REKOMANDUAR "PETROL COMPANY" SH.P.K.
Operatori Ekonomik "Petrol Company" SH.P.K. ka paraqitur dokumente të lëshuara nga OKTA AD – Shkup, të titulluara: "Supply Contract with Manufacturer"
Nga analiza e përmbajtjes së këtyre dokumenteve rezulton se ato nuk përmbushin kërkesën e Dosjes së Tenderit.

1. Dokumenti i paraqitur nuk përbën autorizim nga prodhuesi
Në dokumentet e paraqitura nuk ekziston asnjë deklaratë e qartë me të cilën OKTA, autorizon Petrol Company për këtë aktivitet të prokurimit, nuk autorizon Petrol Company për furnizimin e Autoritetit Kontraktues, nuk garanton furnizimin për kontratën konkrete i cili është objekt i këtij aktiviteti.
Në dokument thuhet: "...a valid supply contract is in effect with Petrol Company..."
Kjo deklaratë vetëm konfirmon ekzistencën e një kontrate furnizimi ndërmjet OKTA dhe Petrol Company. Në vetvete, ajo nuk konfirmon se produktet e furnizuara janë prodhuar apo rafinuar nga OKTA.
Për më tepër, nga informacionet publike të disponueshme rezulton sipas historikut zyrtar të vetë kompanisë OKTA, në janar të vitit 2013 rafineria ndërpreu procesin e prodhimit dhe kompania filloi transformimin në një kompani logjistike dhe tregtare, e fokusuar në magazinimin, transportin dhe furnizimin me derivate të naftës. Për rrjedhojë, ekzistenca e një kontrate furnizimi nuk mund të interpretohet si provë se OKTA është prodhuese e produkteve të naftës, por vetëm se ajo vepron si furnizuese ose ndërmjetëse në zinxhirin e furnizimit..
Një kontratë furnizimi nuk është e njëjtë me autorizim nga prodhuesi, garancion nga

prodhuesi, konfirmim nga prodhuesi që garanton furnizimin për kontratën specifike.
Autoritetit Kontraktues nuk ka kërkuar thjesht dëshmi për ekzistencën e një kontrate tregtare, por ka kërkuar dokument që garanton furnizimin nga prodhuesi/rafineria.

3. Dokumenti vetë identifikon HELLENiQ ENERGY Greece si prodhues
Në faqen e dytë të dokumentit thuhet: "The Client is currently supplied by OKTA with oil derivatives manufactured by HELLENiQ ENERGY Greece."
Nga kjo deklaratë rezulton se: produktet furnizohen përmes OKTA-s, por produktet janë të prodhuara nga HELLENiQ ENERGY Greece.
Pra, vetë dokumenti identifikon një subjekt tjetër si prodhues të derivateve.
Për rrjedhojë, dokumentet e paraqitura nga OE i rekomanduar nuk dëshmojnë se konfirmimi është lëshuar nga prodhuesi i produkteve objekt i furnizimit, siç kërkohet në Dosjen e Tenderit.

4. Dokumenti nuk garanton furnizimin për kontratën objekt të tenderit
Është shqetësuese fakti se Autoriteti Kontraktues ka kërkuar këtë dokument pikërisht për të siguruar furnizimin e kontratës, ndërsa dokumentet e paraqitura nga OE i rekomanduar nuk përmbajnë një garanci të tillë.
Në dokument thuhet: "OKTA expressly states that the aforementioned contract is not exclusive."
Pra, vetë dokumenti deklaron se kontrata nuk është ekskluzive.
Gjithashtu thuhet: "OKTA assumes no responsibility for the quality or quantity delivered by Petrol Company."
Me këtë deklaratë OKTA përcakton se: nuk merr përgjegjësi për sasinë e furnizimit, nuk merr përgjegjësi për cilësinë e produkteve dhe nuk merr përgjegjësi për furnizimin që Petrol Company do t'ia bëjë Autoritetit Kontraktues.
Kjo është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me qëllimin e kërkesës së Autoritetit Kontraktues, e cila kërkonte:
garancion, autorizim apo konfirmim nga prodhuesi/rafineria që garanton furnizimin për kontratën.

Lidhur me dokumentacionin e paraqitur nga OKTA – Shkup dhe natyrën juridike të tij
Një fakt shtesë që e forcon edhe më shumë pretendimin tonë lidhur me mosplotësimin e kërkesës për Autorizim nga Prodhuesi është se, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të procedurës, rezulton se dy operatorë ekonomikë të ndryshëm, të cilët kanë ofertuar për lote të ndryshme në këtë aktivitet të prokurimit, kanë paraqitur dokumentacion të lëshuar nga i njëjti subjekt – OKTA AD Shkup, me përmbajtje të ngjashme/të njëjtë të titulluar "Supply Contract with Manufacturer".

Ky fakt ngre dyshime të arsyeshme lidhur me natyrën juridike të këtij dokumenti, pasi një dokument i tillë, i cili paraqitet si dëshmi e autorizimit nga prodhuesi, nuk përcakton në mënyrë të qartë se cili operator ekonomik është i autorizuar, në çfarë cilësie, për cilin aktivitet prokurimi dhe me çfarë përgjegjësie konkrete të prodhuesit për furnizimin dhe realizimin e kontratës.
Një Autorizim nga Prodhuesi, për nga natyra e tij juridike, duhet të jetë një dokument

Fakti që i njëjti lloj dokumenti nga i njëjti subjekt (OKTA AD – Shkup) është përdorur nga më shumë se një operator ekonomik ("Petrol Company" Sh.p.k dhe EX FIS Sh.P.K nga i njëjti Furnizues jo Autorizues) në të njëjtën procedurë prokurimi, për lote të ndryshme, tregon se ky dokument më shumë paraqet një marrëdhënie të përgjithshme tregtare/furnizimi ndërmjet palëve dhe jo një autorizim specifik të prodhuesit, siç është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit.
Për më tepër, nëse Autoriteti Kontraktues ka konsideruar se dokumenti i paraqitur nga Grupi i Operatorëve Ekonomik "LAB OIL" Sh.p.k. & N.T "Fer Petroll" Sh.p.k. nuk përbën autorizim të vlefshëm nga prodhuesi, atëherë i njëjti standard vlerësimi është dashur të zbatohet edhe ndaj operatorëve të tjerë ekonomikë që kanë paraqitur dokument të së njëjtës natyrë nga i njëjti subjekt.

SHKELJET E LIGJIT PËR PROKURIMIN PUBLIK

Shkelja e Nenit 1 të LPP-së

Neni 1 i LPP-së përcakton qëllimin e ligjit, përkatësisht sigurimin e: transparencës, konkurrencës së drejtë, trajtimit të barabartë, përdorimit efikas të fondeve publike.
Në rastin konkret këto parime janë cenuar, pasi Autoriteti Kontraktues ka zbatuar standarde të ndryshme për operatorët ekonomikë gjatë vlerësimit.

Shkelja e Nenit 7 të LPP-së

Neni 7 i LPP-së obligon Autoritetin Kontraktues që: të trajtojë të gjithë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë, të mos diskriminojë operatorët ekonomikë, të zhvillojë procedurën në mënyrë transparente.
Në rastin konkret: oferta jonë është eliminuar për mungesë të dokumentit nga prodhuesi–rafineria, ndërsa OE i rekomanduar është shpallur i përgjegjshëm edhe pse dokumentet e tij nuk dëshmojnë përmbushjen e së njëjtës kërkesë.
Ky veprim përbën trajtim të pabarabartë.

Shkelja e Nenit 59 të LPP-së

Neni 59 i LPP-së obligon Autoritetin Kontraktues që: të shqyrtojë dhe vlerësojë ofertat sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit, të zbatojë të njëjtat kritere për të gjithë operatorët ekonomikë.
Nëse dokumentet e OKTA-s janë konsideruar të mjaftueshme për OE "Petroll Company", atëherë i njëjti standard është dashur të zbatohej edhe për ofertën tonë.
Nëse ato dokumente nuk përmbushin kërkesën e Dosjes së Tenderit, atëherë edhe oferta e OE të rekomanduar është dashur të konsiderohet e papërgjegjshme.

Shkelja e Nenit 64 të LPP-së – Dëshmitë e Kërkesave

Neni 64 i LPP-së lidhet me obligimin e operatorëve ekonomikë për të paraqitur dëshmi që provojnë përmbushjen e kërkesave të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues.
Në këtë rast, kërkesa e Dosjes së Tenderit ka qenë e qartë: Dokument nga prodhuesi – rafineria që garanton furnizimin për kontratën konkrete.
Dokumentet e paraqitura nga OE "Petroll Company" SH.P.K. nuk provojnë këtë fakt.
Ato vetëm dëshmojnë ekzistencën e një marrëdhënieje furnizimi ndërmjet OKTA-s dhe Petrol Company, por nuk deshmojn autorizim nga prodhuesi, garanci nga prodhuesi, konfirmim nga prodhuesi për furnizimin e kësaj kontrate.

Shkelja e Nenit 66 të LPP-së – Përshtatshmëria Profesionale

Neni 66 i LPP-së kërkon që operatorët ekonomikë të dëshmojnë përshtatshmërinë profesionale dhe aftësinë për realizimin e kontratës.
Kërkesa për dokument nga prodhuesi/rafineria është vendosur pikërisht për të siguruar se operatori ekonomik ka burim të qëndrueshëm dhe të besueshëm furnizimi.
Dokumentet e OE "Petroll Company" SH.P.K. nuk ofrojnë një siguri të tillë, pasi vetë

KUNDËRSHTIM NDAJ VENDIMIT TË AK-AQP-SË PËR REFUZIMIN E KËRKESËS PËR RISHQYRTIM

Grupi i Operatorëve Ekonomikë "LAB OIL" Sh.p.k. & N.T "Fer Petroll" Sh.p.k., e kundërshton vendimin e Autoritetit Kontraktues – AQP për refuzimin e kërkesës sonë për rishqyrtim, pasi konsideron se përgjigjja e dhënë nga AK-AQP nuk i ka adresuar në mënyrë konkrete dhe të argumentuar pretendimet kryesore të ngritura në kërkesën tonë.
Në veçanti, AK-AQP nuk ka dhënë përgjigje konkrete lidhur me pretendimin tonë se dokumenti i paraqitur nga OE i rekomanduar, i lëshuar nga OKTA, nuk përmbush kërkesën e Dosjes së Tenderit për garancion, autorizim apo konfirmim nga prodhuesi/rafineria që garanton furnizimin për kontratën/lotin specifik.
Mbi arsyetimin e ak-aqp-së se okta është pjesë e grupiT HELLENiQ ENERGY AK-AQP, në përgjigjen e saj, arsyeton se:
"Konfirmimi nga OKTA është pranuar pasi që OKTA është pjesë e grupit HELLENiQ ENERGY që është prodhues i karburanteve."
Ky arsyetim nuk është i mjaftueshëm për të dëshmuar përmbushjen e kërkesës së Dosjes së Tenderit.
Kërkesa e Dosjes së Tenderit ka qenë e përcaktuar në mënyrë të qartë:
"Garancion apo autorizim apo konfirmim nga prodhuesi – rafineria, që garanton se do të furnizojë për kontratën/lotin e specifikuar në të cilin ofertoni – origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur."
Nga përmbajtja e kësaj kërkese rezulton qartë se AK ka kërkuar jo thjesht dëshmi për ekzistimin e një marrëdhënieje tregtare, por një dokument që: vjen nga prodhuesi/rafineria qe është garancion, autorizim ose konfirmim dhe garanton furnizimin për kontratën/lotin specifik.
Prandaj, gjatë vlerësimit AK-AQP ka qenë e obliguar të shqyrtojë përmbajtjen konkrete të dokumentit të paraqitur dhe jo vetëm marrëdhënien ndërmjet OKTA-s dhe HELLENiQ ENERGY.
Fakti që OKTA është pjesë e grupit HELLENiQ ENERGY nuk do të thotë automatikisht se çdo dokument i lëshuar nga OKTA përbën dokument të prodhuesit, në kuptim të kërkesës së Dosjes së Tenderit.
Në rastin konkret ekziston një dallim i rëndësishëm ndërmjet subjektit që e ka lëshuar dokumentin dhe subjektit që në vetë dokumentin identifikohet si prodhues.
Dokumenti i paraqitur nga OE i rekomanduar është lëshuar nga OKTA, ndërsa në përmbajtjen e tij përmendet HELLENiQ ENERGY Greece si subjekt që ka prodhuar produktet.
Për këtë arsye, AK-AQP ka qenë e obliguar të sqarojë se mbi çfarë baze e ka konsideruar dokumentin e OKTA-s si "garancion, autorizim apo konfirmim nga prodhuesi – rafineria", kur vetë dokumenti identifikon një subjekt tjetër si prodhues.
Nëse sipas AK-AQP-së HELLENiQ ENERGY është prodhuesi/rafineria, atëherë duhet të ekzistojë në dokumentacion një deklarim, autorizim, konfirmim apo garancion nga ky prodhues që lidhet me furnizimin e kontratës/lotit konkret.
Përkatësia e OKTA-s në të njëjtin grup nuk mund të zëvendësojë dokumentin e kërkuar

Në rastin konkret, AK-AQP nuk mund të kërkojë nga një operator ekonomik dokument të drejtpërdrejtë nga prodhuesi/rafineria, ndërsa për një operator tjetër ta konsiderojë të mjaftueshëm një dokument të lëshuar nga një subjekt tjetër vetëm për shkak të lidhjes së tij korporative me grupin e prodhuesit.
Nëse standardi i zbatuar ndaj Grupit tonë ka qenë se dokumenti duhet të jetë nga prodhuesi/rafineria, atëherë i njëjti standard është dashur të zbatohet edhe ndaj OE të rekomanduar.
Një element shtesë që duhet të merret në konsideratë është fakti se në Njoftimin për Kontratë Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar se variantet nuk lejohen.
Në këtë kontekst, pranimi i një mënyre alternative për përmbushjen e kërkesës së Dosjes së Tenderit nuk mund të justifikohet vetëm me faktin se subjekti që ka lëshuar dokumentin është pjesë e një grupi ku bën pjesë prodhuesi.
Nëse Dosja e Tenderit ka kërkuar dokument nga prodhuesi/rafineria, atëherë gjatë vlerësimit duhet të verifikohet përmbushja e kësaj kërkese pikërisht sipas përmbajtjes dhe formës së kërkuar, dhe jo të pranohet një dokument i një subjekti tjetër si ekuivalent, pa një bazë të qartë në dokumentet e tenderit.
Për këtë arsye, edhe fakti se variantet nuk janë lejuar e përforcon nevojën që kërkesat e Dosjes së Tenderit të zbatohen ashtu siç janë publikuar dhe në mënyrë të njëjtë për të gjithë operatorët ekonomikë.
Nga sa më sipër rezulton se AK-AQP nuk ka dhënë përgjigje konkrete dhe të argumentuar ndaj pretendimit tonë kryesor, por ka arsyetuar pranimin e dokumentit të OKTA-s vetëm me faktin se kjo kompani është pjesë e grupit HELLENiQ ENERGY.
Ky fakt, në vetvete, nuk dëshmon se dokumenti i paraqitur përmbush kërkesën e Dosjes së Tenderit për:
"Garancion apo autorizim apo konfirmim nga prodhuesi – rafineria, që garanton se do të furnizojë për kontratën/lotin e specifikuar..."
Për më tepër, vetë dokumenti identifikon HELLENiQ ENERGY Greece si prodhues të produkteve, ndërsa dokumenti është lëshuar nga OKTA dhe përmban deklarim se OKTA nuk merr përgjegjësi për cilësinë dhe sasinë e produkteve të dorëzuara nga OE i rekomanduar.
Për rrjedhojë, AK-AQP ka qenë e obliguar të vërtetojë në mënyrë konkrete se ku dhe si është përmbushur kërkesa për garancion/autorizim/konfirmim nga prodhuesi për lotin konkret. Një arsyetim i përgjithshëm mbi përkatësinë e OKTA-s në grupin HELLENiQ ENERGY nuk është i mjaftueshëm.
Duke pasur parasysh se oferta e Grupit tonë ka qenë oferta me çmimin më të ulët për Lotin 4 dhe Lotin 9, me një diferencë të përgjithshme prej 122,099.47 €, është veçanërisht e rëndësishme që vlerësimi i ofertave të jetë bërë mbi bazën e të njëjtave kërkesa dhe me të njëjtin standard për të gjithë operatorët ekonomikë.
Për këto arsye, mbetemi pranë të gjitha pretendimeve të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim dhe kërkojmë që vendimi i AK-AQP-së për refuzimin e saj të rishikohet dhe të korrigjohet, si dhe të bëhet rivlerësimi i ofertave në përputhje me kërkesat e Dosjes së

Tenderit, LPP-në dhe parimin e trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

KRITERET PËR VLERËSIM

Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik	6.4	**Kërkesat e Pranueshmërise:** **Kërkesa 1:** Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin. No. 05/L-092. LPP mund të shkarkohet nga http://krpp.rks-gov.net. **Dëshmia e kërkuar dokumentare:** **Evidenca 1: Një deklarata e shkruar nën Betim**, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2. **Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërise qe kërkohen nga tenderuesi qe propozohet qe te shpërblehet me kontrate dhe dorëzohen te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit për Dhënie te Kontratës:** **Dokumentet te cilat do te kërkohen si dëshmi për përmbushje te kërkesave te pranueshmërise janë me se vijon:** **Vërtetim te është nga gjykata** apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit për situatën referuar nenit 65, paragrafi 3, nen-paragrafi 3.1, 3.2, 3.3, 3.4, 3.5 dhe 3.6 dhe paragrafi 4, nen-paragrafi 4.1, 4.2, dhe 4.4, (jo me e vjetër se 6 muaj para datës se dorëzimit të tenderit - kërkohet – **Valide** **2. Një vërtetim te lëshuar nga Administrata Tatimore** e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve dhe kontributeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës se dorëzimit të tenderit).-**Valide** Dështimi i Operatorit Ekonomik qe është propozuar qe te shpërblehet me kontrate te sjelle dokumentet te kërkuara ne piken, 1 dhe 2 i jep te drejte Autoritetit Kontraktues qe ofertën ta refuzoj, ta beje konfiskimin e garancionit për sigurim te ofertës dhe te vazhdoj me shpërblim te kontratës me Operatorin Ekonomik qe është rendit ne vendin e dyte e kështu me radhe. Në lidhje me dispozitat e tjera të përcaktuara në Nenin 6 si dhe në rastin kur lëshimi i dokumenteve dhe certifikatave që referohen më lart është i pamundshëm për arsye objektive, apo kur dokumentet nuk mbulojnë të

		gjitha rastet për të cilat është nxjerrë dëshmia, një deklaratë nën betim nga tenderuesi mund të pranohet si dëshmi e mjaftueshme. Në rast se tenderi dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik, të gjithë anëtarët e këtij grupi duhet të dorezojnë dëshmi mbi përshtatshmërinë e tyre sipas nenit Pjesën 6.4 të FDT-së, kjo vlen edhe per nenkontraktoret. Dështimi për të paraqitur një nga këto dokumente brenda afatit kohor, do të thotë që tenderuesi do të refuzohet , do ti konfiskohet garancioni i sigurimit te ofertës dhe AQP do të vazhdojë me tenderuesin e radhës në rang-listë.

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	7.1	**Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale:** **Kërkesa 1.** Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/apo Regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit; **Kërkesa 2.** Operatori ekonomik duhet të jetë i licencuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë(MTI) se Republikës së Kosovës për import, shitje me shumice, shitje me pakicë si dhe licencë për transport të derivateve të Karburanteve naftë dhe benzin.

	7.2	**Dokumentet dëshmuese për përshtatshmëri profesionale** **Evidenca 1:** Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend (Çertifikata e regjistrimit te biznesit) . **Evidenca 2:** Licencat për shërbime në sektorin e karburanteve: 1. Licenca e importit – **Valide** Licenca e shitjes me shumicë – **Valide** Licenca e transportit – **Valide** Licencën e shitjes më pakicë për pikat e karburantit të paraqitura nga Operatori Ekonomik (aneksi 9) për ofrimin e furnizime me karburante – Valide Për pikat e karburantit qe priten te nënkontraktohen duhet të dorëzohen Licencat e shitjes më pakicë dhe marrëveshjet për nënkontraktim. Te gjitha licencat e lëshuara nga institucionet perkatse duhet që të kenë afat të validitetit në kohen e dorëzimit te ofertës. Dështimi i Operatorit Ekonomik që është propozuar që të shpërblehet me kontrate të dorëzoj Licencat e shitjes më pakicë dhe marrëveshjet për nën-kontraktim për pikat e karburantit të nën-kontraktuara, i jep te drejte Autoritetit Kontraktues që ofertën ta refuzoj, të bëjë konfiskimin e garancionit për sigurim të ofertës dhe të vazhdoj me shpërblim të kontratës Operatorin Ekonomik që është rendit ne vendin e dyte e kështu me radhe.

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1	**Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare** **Kërkesa 1:** Operatori ekonomik duhet të ketë realizuar qarkullim minimal vjetor per tri vitet e shkuara, **xhiro totale në EURO** minimum: **Lot 1 – 10,380,000.00€** **Lot 2 – 5,420,000.00€** **Lot 3 – 3,520,000.00€** **Lot 4 – 7,400,000.00€** **Lot 5 – 4,340,000.00€** **Lot 6 – 1,350,000.00€** **Lot 7 – 2,610,000.00€** **Lot 8 – 3,020,000.00€** **Lot 9 – 1,420,000.00€** **Në rast se operatori ekonomik dorëzon tender për te gjitha pjesët (lote), shuma totale e qarkullimit financiar qe kërkohet për tu shpërblyer me kontratë për të gjitha Pjesët-Lotet është totali i gjithave apo 39,460,000€ .** **Apo në rast se OE oferton vetëm për disa Pjesë-Lote per tu shpërblyer me kontratë duhet të plotësoj kërkesën duke pasur qarkullimin financiar në vlerën e atyre Pjesëve-Loteve së bashku (vlerat e paraqitura më lartë duhet të mblidhen për Pjesët që ofertoni).** **Kërkesa 2:**Operatori ekonomik duhet të dëshmoj se ka kapital financiar për realizimin e kontratës, mjete të gatshme në bankë ose mbështetje bankare qasje te pakushtezuar në kredi për realizimin e kontratës ose bilanc pozitive tek Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit ne Pasqyra e rrjedhjes së parasë për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025- në vlerë prej së paku: **Lot 1 – 775,000.00€** **Lot 2 – 405,000.00€** **Lot 3 – 264,000.00€**

		Lot 4 – 550,000.00€ **Lot 5 – 325,000.00€** **Lot 6 – 100,000.00€** **Lot 7 - 195,000.00€** **Lot 8 – 225,000.00€** **Lot 9 – 105,000.00€**

	8.2	**Dokumentet dëshmuese për gjendjen ekonomike dhe financiare** **Evidenca 1:** Deklaratat Tatimore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës për 3 vitet e shkuara. Operatori ekonomik qe përmbush kërkesën e qarkullimit vetëm me një apo dy vite. Do të thotë se OE ka përmbushur kërkesën minimale te përcaktuar ne dokumentet e tenderit, kusht i domosdoshëm dhe i detyrueshëm për t'u kualifikuar. **Evidenca 2:** Deklaratë nga banka që dëshmon se OE ka mjete të gatshme në xhirollogari ose qasje te pakushtezuar në kredi për realizimin e kontratës ose Pasqyra e rrjedhjes së parasë për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025 në vlerë prej minimumit te paraqitur tek kërkesa per secilin Lot qe oferton. Nese dorëzohet dëshmi nga banka per mjete te gatshme dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni Bankar. Në rastin e kredisë se pakushtezuar OE duhet të paraqes dokumentin nga banka në emër të aktivitetit te prokurimit – origjinal. Në rast se dorëzohen pasqyra e rrjedhës se parasë per vitin qe përfundon me 31.12.2025 duhet te jene te nënshkruara nga auditorët – rishikim i pasqyrave financiare.

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1	**Kërkesa 1:** Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses furnizim me karburante në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te këtij njoftimi për kontrate) jo me pak se: **Lot 1 – 7,785,000.00€** **Lot 2 – 4,065,000.00€** **Lot 3 – 2,640,000.00€** **Lot 4 – 5,550,000.00€** **Lot 5 – 3,225,000.00€** **Lot 6 – 1,010,000.00€** **Lot 7 - 1,955,000.00€** **Lot 8 – 2,265,000.00€** **Lot 9 – 1,065,000.00€** **Në rast se operatori ekonomik dorëzon tender për te gjitha pjesët (lote), shuma totale e dëshmive qe kërkohet për tu shpërblyer me kontratë për të gjitha Pjesët-Lotet është totali i gjithave apo 29,590,00€ .** **Apo në rast se OE oferton vetëm për disa Pjesë-Lote per tu shpërblyer me kontratë duhet të plotësoj kërkesën duke pasur dëshmit në vlerën e atyre Pjesëve-Loteve së bashku (vlerat e paraqitura më lartë duhet të mblidhen për Pjesët që ofertoni).** **Kërkesa 2:**Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka në dispozicion mjetet transportuese të regjistruara dhe të bazhdaruara/verifikuar për rrjedhjen dhe vëllimin e autoboteve, për realizim të kontratës –per LOT 1 dhe Lot 3 nga 4 autobot. Per Lot 4 – 5 autobot. Për Lot 5,6,7,8 dhe 9	

		kërkohet nga 2 autobot për secilin Lot. Per tu shpërblyer me kontrate në disa Lote duhet te plotësoj kriteret për të gjitha mjetet e kërkuara per ato Lote. (p.sh per tu shpërblyer me Lot 1, Lot 5 dhe Lot 9 duhet të ketë 8 autobote). **Kërkesa 3:**Operatori Ekonomik duhet të dorëzoj një listë të pikave të shitjes se karburanteve qe planifikon për ti shfrytëzuar për realizimin e kontratës. Vendet e pikave te shitjes te cilat kërkohen janë të specifikuara në Aneksin 9; Pavarsisht pikave të cekura nga ana e oferturesit gjatë realizimit të kontratës kontraktuesi ka obligim që ti ofrojë shfrytëzuesve të kontratës të gjitha pikat e veta në territorin e Kosovës, për rastet kur ofertoni si Grup i OE këtë obligim e ka lideri i Grupit. – **Kjo kërkese nuk vlenë për Lot 3 dhe Lot 4 (vlen per të gjitha Lotet tjera).** **Kërkesa 4:** Garancion apo autorizim apo konfirmim nga raftineria/prodhuesi **Kërkesa 5:** Deklarat e kualitetit mbi plotësimin e specifikave teknike per AD-Blue – **Kjo kërkese nuk vlenë për Lot 3 dhe Lot 4 (vlen per të gjitha Lotet tjera).** **Kërkesa 6:** Deklarate me shkrim e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori	

		Ekonomik i cili deklaron se ka kapacitet për të mbajtur dhe do të mbaje rezerva gjatë gjith implementimit te kontratës per sasinë: Lot 1: 1,000,000 Litra Nafte dhe 60,000 Litra Benzinë; Lot 3: 500,000 Litra Naftë dhe 20,000 Litra Benzinë – **Vlen vetëm per Lot 1 dhe Lot 3 (nese ofertoni vetem ne njërën nga keto Lote duhet te plotësoni deklaratën vetëm për atë Lot.)** **Bazuar në këtë kërkesë pjesë e kontratës do të jetë:** Për Lot 1 - Policia Kosovës ndërsa Për Lot 3 – MM/FSK ne koordinim me institucionet tjera ne çdo kohe ka te drejte dhe mund te beje inspektime për te konfirmuar posedimin e rezervave te kërkuara nga OE	

	9.2	**Dokumentet dëshmuese për mundësitë teknike dhe/ose profesionale** **Evidenca 1:**Operatori Ekonomik duhet te plotësoj formularin standard të dhënë në Aneksin 8 te Dosjes se Tenderit dhe te bashkëngjis certifikatat përkatëse ose ndonjë dokument tjetër qe evidenton liferimin e tillë, ; (i) kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e certifikatës (certifikata /raporti i përkohshëm i pranimit) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë-nënshkruara nga autoriteti i tillë. të gjitha këto dëshmi duhet të kenë vlerën e realizuar. (ii) kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë me dëshmi të pagesës nga banka; **Evidenca 2:** Listën e mjetet transportuese për realizimin e kontratës se bashku me kopjet librezave valide te regjistrimit te automjeteve dhe certifikatën/raportet e verifikimit për rrjedhjen dhe vëllimin e autoboteve e lëshuara nga institucionet kompetente me afat. **Evidenca 3:** Plotësimi i Aneksit 9 – te dosjes se tenderit duke plotësuar	

		kërkesat e lokacioneve te pikave te karburantit. **Evidenca 4:**Garancion apo autorizim apo konfirmim nga prodhuesi / raftineria – që garanton që do të furnizoj per kontratën/Lotin e specifikuar në të cilën ofertoni – origjinal e nënshkruar dhe vulosur. **Evidenca 5:** Deklarat me shkrim e kualitetit mbi plotësimin e specifikave teknike per AD-Blue të paraqitura në Aneksin 1. **Evidenca 6:** Deklarate me shkrim e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik	

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

IDENTIFIKIMI I TENDERUESVE TË REKOMANDUAR PËR DHËNIE TË KONTRATËS

Nr:	Grupi:		
1	Lot 1 – Furnizim me karburante për nevojat e Policisë së Kosovës		
	Emri i tenderuesit të suksesshëm	**Kodi postar**	**Adresa**
	Grup i Operatorëve Ekonomik HIB PETROL SH.P.K.; HIB Petrol Corporation SH.P.K.; HIB Distribution SH.P.K.	10000	Magjistralja Prishtine- Shkup , km 7, HIB Petrol
2	Lot 2 – Furnizim me karburante për vetura për nevojat e institucioneve publike të Nivelit Qendror		
	Emri i tenderuesit të suksesshëm	**Kodi postar**	**Adresa**
	IP - KOS SH.P.K., 60105444	-10500	Rr. Pennsylvania Nr. 41 (Marigona Residence)
3	Lot 3 – Furnizim me karburante për nevojat e MM dhe FSK-së		
	Emri i tenderuesit të suksesshëm	**Kodi postar**	**Adresa**
	Grup i Operatorëve Ekonomik HIB PETROL SH.P.K.; HIB Petrol Corporation SH.P.K.; HIB Distribution SH.P.K.	10000	Magjistralja Prishtine- Shkup , km 7, HIB Petrol
4	Lot 4 – Furnizim me karburante për nxehmje gjenerator dhe rezerva për nevojat e institucioneve publike të Nivelit Qendror		
	Emri i tenderuesit të suksesshëm	**Kodi postar**	**Adresa**
	Petrol Company - SH.P.K., 810527195	10000	, Magjistralja Pr-F.Kosovë
5	Lot 5 – Furnizim me karburante për Rajonin e Prishtinës (Nivel Lokal)		
	Emri i tenderuesit të suksesshëm	**Kodi postar**	**Adresa**
	IP - KOS SH.P.K., 60105444	-10500	Rr. Pennsylvania Nr. 41 (Marigona Residence)
6	Lot 6 – Furnizim me karburante për Rajonin e Prizrenit (Nivel Lokal)		
	Emri i tenderuesit të suksesshëm	**Kodi postar**	**Adresa**
	Grup i Operatorëve Ekonomik HIB PETROL SH.P.K.; HIB Petrol	10000	Magjistralja Prishtine- Shkup , km 7, HIB Petrol

Nr:	Grupi:		
	Corporation SH.P.K.; HIB Distribution SH.P.K.		
7	Lot 7 – Furnizim me karburante për Rajonin e Pejës dhe Gjakovës (Nivel Lokal)		
	Emri i tenderuesit të suksesshëm	**Kodi postar**	**Adresa**
	IP - KOS SH.P.K., 60105444	-10500	Rr. Pennsylvania Nr. 41 (Marigona Residence)
8	Lot 8 – Furnizim me karburante për Rajonin e Ferizajit dhe Gjilanit (Nivel Lokal)		
	Emri i tenderuesit të suksesshëm	**Kodi postar**	**Adresa**
	Grup i Operatorëve Ekonomik HIB PETROL SH.P.K.; HIB Petrol Corporation SH.P.K.; HIB Distribution SH.P.K.	10000	Magjistralja Prishtine- Shkup , km 7, HIB Petrol
9	Lot 9 – Furnizim me karburante për Rajonin e Mitrovicës (Nivel Lokal)		
	Emri i tenderuesit të suksesshëm	**Kodi postar**	**Adresa**
	Petrol Company - SH.P.K., 810527195	10000	, Magjistralja Pr-F.Kosovë

DEKLARATË

Pas ekzaminimit dhe vlerësimit të ofertave, komisioni i vlerësimit ka evidentuar se ne aktivitetin e prokurimit: Furnizim me karburante" me numër te prokurimit 201/26300-26-2068-1-1-1 kanë ofertuar pesë (5) operatorë ekonomik. Gjatë vlerësimit te ofertave komisioni i vlerësimit ka konstatuar se operatoret ekonomik:

1. Grupi i Operatorëve Ekonomikë: LAB-OIL SH.P.K. & N.T. "Fer-Petroll"

Grupi i Operatorëve Ekonomikë LAB-OIL SH.P.K. & N.T. "Fer-Petroll" ka dorëzuar ofertë për Lotet nr. 4 dhe 9.

Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të ofertës, Komisioni i Vlerësimit ka konstatuar se OE nuk e ka përmbushur kërkesën e përcaktuar në Dosjen e Tenderit, përkatësisht:

Kërkesa nr. 4: Garancion, autorizim apo konfirmim nga rafineria/prodhuesi.

Evidenca nr. 4: Garancion, autorizim apo konfirmim nga prodhuesi/rafineria, me të cilin garantohet furnizimi për kontratën dhe lotin specifik për të cilin ofertuesi ka dorëzuar ofertë, në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur.

Kjo kërkesë ka të bëjë me kapacitetet teknike dhe/ose profesionale dhe përbën kërkesë thelbësore të Dosjes së Tenderit dhe Njoftimit për Kontratë.

Autoriteti Kontraktues nuk ka kërkuar sqarime lidhur me referencat, pasi mungesa e autorizimit apo garancionit nga rafineria/prodhuesi nuk mund të plotësohet apo të ndryshohet përmes sqarimeve pas dorëzimit të ofertës.

Për rrjedhojë, oferta e këtij grupi të operatorëve ekonomikë është vlerësuar si e papërgjegjshme për Lotet nr. 4 dhe 9 dhe nuk rekomandohet për dhënie të kontratës.

2. Operatori Ekonomik: EX FIS-K

Operatori Ekonomik EX FIS-K ka dorëzuar ofertë për Lotet nr. 1, 2, 3, 4, 6 dhe 8.

Për Lotet nr. 2 dhe 4, oferta e OE-së nuk mund të rekomandohet për dhënie të kontratës, pasi vlera e ofertuar tejkalon vlerën e parashikuar të kontratës për këto lote.

Për Lotet nr. 1, 3, 6 dhe 8, Komisioni i Vlerësimit nuk e ka parë të arsyeshme kërkimin e sqarimeve shtesë lidhur me realizimin e kontratave dhe referencat e deklaruara, pasi oferta e këtij OE nuk është oferta me çmimin më të ulët ndër ofertat e përgjegjshme.

Për rrjedhojë, Operatori Ekonomik EX FIS-K nuk rekomandohet për dhënie të kontratës për asnjërin nga lotet për të cilat ka ofertuar.

3. Grupi i Operatorëve Ekonomikë: HIB PETROL SH.P.K., HIB Petrol Corporation SH.P.K. & HIB Distribution SH.P.K.

Grupi i Operatorëve Ekonomikë HIB PETROL SH.P.K., HIB Petrol Corporation SH.P.K. dhe HIB Distribution SH.P.K. ka dorëzuar ofertë për Lotet nr. 1, 3, 5, 6 dhe 8.

Për Lotin nr. 5, oferta e grupit të operatorëve ekonomikë nuk mund të rekomandohet për dhënie të kontratës, pasi vlera e ofertuar tejkalon vlerën e parashikuar për këtë lot.

Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertës, Komisioni i Vlerësimit ka konstatuar se oferta për Lotet nr. 1, 3, 6 dhe 8 është e përgjegjshme dhe përmbush kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë.

Duke u bazuar në rezultatet e vlerësimit dhe në kriterin e dhënies së kontratës, Komisioni i Vlerësimit rekomandon që **Grupi i Operatorëve Ekonomikë: HIB PETROL SH.P.K., HIB Petrol Corporation SH.P.K. & HIB Distribution SH.P.K.**.t'i jepet kontrata për:

Loti nr. 1: 4.778.714,28 €
Loti nr. 3: 1.579.406,83 €
Loti nr. 6: 623.799,90 €
Loti nr. 8: 1.397.289,71 €

4. Operatori Ekonomik: IP-KOS SH.P.K.

Operatori Ekonomik IP-KOS SH.P.K. ka dorëzuar ofertë për Lotet nr. 1, 2, 5 dhe 7.

Në Aneksin nr. 8 të Dosjes së Tenderit, OE ka deklaruar se posedon referenca të realizuara me subjekte private në vlerë të përgjithshme prej 20.147.250,75 €.

Gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertës, Komisioni i Vlerësimit ka konstatuar se dokumentet e dorëzuara fillimisht së bashku me ofertën nuk kanë qenë të mjaftueshme dhe bindëse për të konfirmuar përmbushjen e kërkesës së Autoritetit Kontraktues lidhur me kapacitetin financiar.

Për këtë arsye, më 07.07.2026, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar sqarime shtese nga Operatori Ekonomik. Më 10.07.2026, Operatori Ekonomik ka dorëzuar dokumentet sqaruese të kërkuara. Pas shqyrtimit të këtyre dëshmive, Komisioni i Vlerësimit ka konstatuar se dokumentacioni i paraqitur nuk ka qenë i mjaftueshëm për të dëshmuar në tërësi përmbushjen e kërkesës së përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues.

Për këtë arsye, më 13.07.2026, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar sqarime shtesë nga Operatori Ekonomik, ndërsa më 14.07.2026, Operatori Ekonomik ka dorëzuar raportet dhe dëshmitë bankare lidhur me referencat financiare të deklaruara.

Pas analizimit dhe verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar, Komisioni i Vlerësimit ka marrë në konsideratë vlerën prej 10.500.000,00 €, pasi kjo vlerë është vlerësuar e mjaftueshme për përmbushjen e kërkesës së kapacitetit financiar për lotet për të cilat Operatori Ekonomik rekomandohet për dhënie të kontratës.
Duke u bazuar në rezultatet e vlerësimit dhe në kriterin e dhënies së kontratës, Komisioni i Vlerësimit rekomandon që Operatorit Ekonomik **IP-KOS SH.P.K.**t'i jepet kontrata për:
Loti nr. 2: 2.677.820,40 €
Loti nr. 5: 2.124.387,95 €
Loti nr. 7: 1.297.836,42 €
Për Lotin nr. 1, OE nuk rekomandohet për dhënie të kontratës, pasi oferta e tij nuk është oferta me çmimin më të ulët ndër ofertat e përgjegjshme.

5. Operatori Ekonomik: PETROL COMPANY

Operatori Ekonomik PETROL COMPANY ka dorëzuar ofertë për lotet nr. 1, 2, 3, 4, 5, 7 dhe 9. Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertës, Komisioni i Vlerësimit ka konstatuar se operatori ekonomik i plotëson kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe se oferta e tij është e përgjegjshme.

Gjatë procesit të vlerësimit ekonomik është konstatuar se:

për Lotin nr. 3, oferta nuk mund të rekomandohet për dhënie të kontratës, pasi vlera e ofertës tejkalon vlerën e parashikuar për këtë lot;
për Lotet nr. 1, 2, 5 dhe 7, oferta nuk mund të rekomandohet për dhënie të kontratës, pasi nuk paraqet ofertën me çmimin më të ulët ndër ofertat e përgjegjshme.

Duke u bazuar në rezultatet e vlerësimit dhe në kriterin e dhënies së kontratës, Komisioni i Vlerësimit rekomandon që Operatorit Ekonomik PETROL COMPANY t'i jepet kontrata për:

Lotin nr. 4, në vlerë prej 3.697.763,56 €;
Lotin nr. 9, në vlerë prej 709.792,59 €.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

OE ankues eshte pale me interes sipas nenit 4.1.26 te LPP-se

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **LAB-OIL SH.P.K.**

Përshkrim i përgjithshëm:

Autoriteti Kontraktues (AK) Agjencia Qendrore e Prokurimit ka zhvilluar procedurën e prokurimit me titull: Furnizim me karburante " me nr. të prokurimit: 201/26300-26-2068-1-1-1.

Ky aktivitet i prokurimit është i ndarë ndare në **9 Pjesë (Lote).**

OE ankues "LAB-OIL SH.P.K."- Prishtinë me seli në Prishtinë, ka paraqitur ankesë për pjesët:

Lot 4 – Furnizim me karburante për nxehmje/gjenerator dhe rezerva për nevojat e institucioneve publike të Nivelit Qendror - 3,700,000.00€

Lot 9 – Furnizim me karburante për Rajonin e Mitrovicës (Nivel Lokal) -710,000.00€

Në këto dy LOT/Pjesë (4 dhe 9), Autoriteti Kontraktues me vendim të datës: 21.07.2026, ka rekomanduar për kontratë OE "Petrol Company-SH.P.K.", Prishtinë, ndërsa Operatorit Ekonomik ankues i ka dërguar Letër Standarde për tenderuesin e eleminuar, duke e vlerësuar ofertën e tijë si të pa përgjegjshme.

Me datë: 27.07.2026, OE ankues pa paraqitur kërkesë për rishqyrtim të Vendimit të AK, ndërsa AK me datë: 03.08.2026 ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim.

Me datën: 13.08.2026, OE "LAB-OIL SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2026/0595, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "Petrol Company-SH.P.K."-Prishtinë, lidhur me këtë aktivitetin e prokurimit, për LOT/Pjesët 4 dhe 9.

Eksperti shqyrtues ne Pajtim me nenin 114 te LPP-se, ka analizuar pretendimet ankimore të OE ankues dhe në vijim janë pretendimet ankimore dhe shqyrtimi i tyre:

PRETENDIMET ANKIMORE

OE ankues në ankesën e tijë si pretendim ankimor ka paraqitur arësyen e eleminimit të tijë në këtë procedure, e në të njëjtën kohë pretendon që AK, ka përdorur standard të dyfisht sa përket kërkesës nr.9.1.4 të dosjes së tenderit.

Autoriteti Kontraktues, eleminimin e ofertës së OE ankues e ka arësyetur duke deklaruar se OE ankues nuk ka plotësuar kërkesën nr.9.1.4 te kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale të dosjes së tenderit, në të cilën kërkesë Autoriteti Kontraktues ka kërkuar:

Kërkesa 4:

"Garancion apo autorizim apo konfirmim nga rafineria/prodhuesi."

Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar:

Evidenca 4:

"Garancion apo autorizim apo konfirmim nga prodhuesi – rafineria, që garanton se do të furnizojë për kontratën/lotin e specifikuar në të cilin ofertoni – origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur."

Nga formulimi i kësaj kërkese rezulton se Autoriteti Kontraktues nuk ka kërkuar domosdoshmërisht vetëm një dokument të titulluar "Autorizim nga Prodhuesi", por ka paraparë në mënyrë alternative **garancion, autorizim apo konfirmim**, me kusht që dokumenti i paraqitur të dëshmojë lidhjen përkatëse me prodhuesin/rafinerinë dhe furnizimin për LOT/Pjesën për të cilin operatori ekonomik ka ofertuar.

1.Lidhur me dokumentacionin/dëshmitë e ofruara nga ana e OE ankues:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të Grupit të OE **"LAB OIL" SH.P.K. & N.T. "Fer Petroll" SH.P.K.**, rezulton se për përmbushjen e Kërkesës nr. 9.1.4 të dosjes së tenderit është paraqitur autorizim i lëshuar nga **KASTRATI ENERGY TRADE SH.A.**

Mirëpo, nga dokumentacioni i paraqitur nuk rezulton se **KASTRATI ENERGY TRADE SH.A. ka cilësinë e prodhuesit apo rafinerisë** së derivateve objekt i këtij aktiviteti të prokurimit. Po ashtu, dokumentacionit të ofertës nuk i është bashkëngjitur ndonjë garancion, autorizim apo konfirmim nga një prodhues/rafineri, përmes të cilit do të dëshmohej se prodhuesi/rafineria garanton furnizimin për LOT/Pjesët për të cilat ka ofertuar Grupi i OE ankues.

Rrjedhimisht, fakti që dokumenti mban emërtimin "autorizim" nuk është në vetvete i mjaftueshëm për përmbushjen e kërkesës së Dosjes së Tenderit, pasi duhet vlerësuar edhe cilësia e subjektit që e ka lëshuar atë dhe përmbajtja materiale e dokumentit.

Në këtë rast, autorizimi është lëshuar nga një subjekt për të cilin, bazuar në dokumentacionin e ofertës, nuk është dëshmuar se është prodhues/rafineri, ndërsa nuk është krijuar as zinxhiri dokumentar përmes një konfirmimi apo autorizimi të prodhuesit/rafinerisë përkatëse:

KASTRATI

Date: 10.06.2026

GUARANTEE LETER FOR SUPPLY

KASTRATI ENERGY TRADE SH.A., agrees that it will supply **Lab – Oil Sh.p.k, with address Preoc, Highway Prishtine-Skopje, Graqanice – Republic of Kosova with business number 810800153,** With Diesel and gasoline (quality according to the request of the government of Kosova), to meet the Government's needs for the duration of the contract period and any extensions thereof.

Name of the contract: Lot 9 – Supply of Fuel for the Mitrovica Region (Local Level).
Procurement number: **201/26300-26-2068-1-1-1**

Quantity for supply:

- Diesel 600,000 L
- Gasoline 29,000 L

Sincerely

Ardit Kastrati

Head of Trading

KASTRATI ENERGY TRADE SH.A. NIPT: K21711502N LAGJJA 14, DURRËS - ALBANIA

Kastrati Energy Trade Sha | Lagjja 14, Ura Dajlanit, Durrës, AL
info@kastrati-group.com | www.kastrati.al

Për rrjedhojë, eksperti vlerëson se Autoriteti Kontraktues ka pasur bazë që dokumentin e paraqitur nga OE ankues të mos e konsiderojë si përmbushje të Kërkesës nr.9.1.4 të Dosjes së Tenderit. **Pra ky pretendim ankimor është i pa bazuar.**

2.Lidhur me dokumentacionin/dëshmitë e ofruara nga ana e OE të rekomanduar "Petrol Company" SH.P.K.

Sa i përket pretendimit të OE ankues se edhe OE i rekomanduar **"Petrol Company" SH.P.K.** ndodhet në situatë të njëjtë, eksperti vlerëson se ky krahasim nuk mund të pranohet në mënyrën si është paraqitur nga ankuesi.

OE i rekomanduar ka paraqitur dokumentin **"Supply Contract with Manufacturer"**, të lëshuar nga **OKTA AD – Skopje**, e në të cilin dokument është edhe konfirmimi se OCTA AD është pjesë e grupit **HELLENiQ ENERGY:**

OKTA АД - Скопје
ул. 1 бр.25 Миладиновци, п.фах 66, 1000 Скопје
Тел: +389 (0) 2 2532 000 Факс: +389 (0) 2 2577 788

OKTA AD - Skopje
1 Str. 25 Miladinovci, P.O. Box 66, 1000 Skopje
Tel: +389 (0) 2 2532 000 Fax: +389 (0) 2 2577 788
www.okta-elpe.com

SUPPLY CONTRACT WITH MANUFACTURER

To:

OKTA Рафинерија на нафта
Акционерско друштво
Бр. 11/2-1275/26
28.05. 2026 год.
Скопје 1

Central Procurement Agency, Kosovo

Subject:

Supply Contract with Manufacturer – Petrol Company - SH.P.K., Pristina, (UINE: 810527195).

Identification number : **201/26300-26-2068-1-1-1**

Lot 1 – Supply of fuel for the needs of the Kosovo Police

Lot 2 – Supply of fuel for vehicles for the needs of public institutions at the Central Level

Lot 3 – Supply of fuel for the needs of the Ministry of Defense and the KSF

Lot 4 – Supply of fuel for heating/generator and reserves for the needs of public institutions at the Central Level

Lot 5 – Supply of fuel for the Pristina Region (Local Level)

Lot 7 – Supply of fuel for the Peja and Gjakova Regions (Local Level)

Lot 9 – Supply of fuel for the Mitrovica Region (Local Level)

27 May 2026

Dear Sirs,

OKTA Crude Oil Refinery Shareholding Company from Skopje, wholesale trader of fuel derivatives and holder of a valid manufacturing license, owner of the Refinery at Miladinovci, Skopje, subsidiary of HELLENiQ ENERGY Greece and member of the HELLENiQ ENERGY Group of Companies, declares that a valid supply contract is in effect with **Petrol Company - SH.P.K., Pristina,** (hereinafter: the Client) for the supply of oil derivatives (Automotive Diesel 10 ppm and Motor Gasoline).

Pra nga verifikimi i të dhënave dhe dokumentacionit përkatës rezulton se OKTA AD – Skopje është pjesë e grupit **HELLENiQ ENERGY**, ndërsa vetë dokumenti i paraqitur përcakton se Petrol Company furnizohet nga OKTA me derivate të naftës të prodhuara nga **HELLENiQ**

ENERGY Greece.

Në këtë aspekt duhet bërë dallimi ndërmjet dy dokumenteve të paraqitura nga operatorët ekonomikë.

Te OE ankues kemi një autorizim të lëshuar nga **KASTRATI ENERGY TRADE SH.A.**, pa u dëshmuar në dokumentacionin e ofertës cilësia e saj si prodhues/rafineri dhe pa u paraqitur ndonjë dokument i prodhuesit/rafinerisë që garanton ose konfirmon furnizimin.

Në anën tjetër, te OE i rekomanduar dokumenti është lëshuar nga **OKTA AD – Skopje**, kompani pjesë e grupit HELLENiQ ENERGY, dhe në vetë përmbajtjen e dokumentit identifikohet shprehimisht burimi prodhues i produkteve, përkatësisht **HELLENiQ ENERGY Greece**, si dhe marrëdhënia e furnizimit ndërmjet OKTA dhe Petrol Company.

Në rastin konkret, dokumenti i paraqitur nga Petrol Company nuk duhet vlerësuar vetëm nga emërtimi formal i OKTA-s si "Wholesale trader", por në kontekst të plotë të marrëdhënies së dokumentuar ndërmjet **Petrol Company – OKTA – HELLENiQ ENERGY**, ku HELLENiQ ENERGY identifikohet si prodhues i derivateve që furnizohen përmes OKTA-s. Eksperti vlereson se edhe **ky pretendim ankimor është i pa bazuar.**

3.Lidhur me pretendimin për trajtim të pabarabartë

OE ankues pretendon se Autoriteti Kontraktues ka përdorur standarde të ndryshme gjatë vlerësimit, duke e eliminuar ofertën e tij, ndërsa ka konsideruar të përgjegjshme ofertën e Petrol Company.

Eksperti vlerëson se parimi i trajtimit të barabartë kërkon që kërkesa e njëjtë e Dosjes së Tenderit të zbatohet në mënyrë të njëjtë ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë. Megjithatë, **trajtimi i barabartë nuk nënkupton domosdoshmërisht rezultat të njëjtë kur dokumentacioni dhe përmbajtja materiale e dëshmive të paraqitura nga operatorët ekonomikë janë të ndryshme.**

Në rastin konkret, dokumentacioni i OE ankues dhe ai i OE të rekomanduar nuk janë të një natyre dhe fuqie dëshmuese identike.

OE ankues ka paraqitur autorizim nga një subjekt për të cilin nuk është dëshmuar cilësia e prodhuesit/rafinerisë dhe pa dokument mbështetës nga prodhuesi/rafineria, ndërsa OE i rekomanduar ka paraqitur konfirmim nga OKTA AD – Skopje, në të cilin ekziston lidhja e dokumentuar me grupin HELLENiQ ENERGY dhe identifikohet HELLENiQ ENERGY Greece si prodhues i produkteve me të cilat furnizohet Petrol Company.

Për këtë arsye, eksperti nuk gjen bazë të mjaftueshme për konstatimin se Autoriteti Kontraktues ka aplikuar standard të ndryshëm vetëm për faktin se dokumentet kanë formë apo titull të ndryshëm. Përmbushja e kërkesës duhet të vlerësohet sipas **substancës dhe përmbajtjes së dokumentit**, e jo vetëm sipas emërtimit formal të tij. **Andaj edhe ky**

pretendim ankimor është i pa bazuar.

4.Lidhur me pretendimin për çmimin më të ulët dhe dëmin ekonomik

Eksperti ka parasysh pretendimin e OE ankues se oferta e tij ka qenë më e lirë për Lot 4 dhe Lot 9 dhe se rekomandimi i Petrol Company rezulton me një diferencë të përgjithshme prej **122,099.47 €**.

Megjithatë, kriteri i çmimit më të ulët mund të zbatohet vetëm ndërmjet ofertave të cilat paraprakisht janë konstatuar si të përgjegjshme dhe që i plotësojnë kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë.

Fakti se një ofertë ka çmim më të ulët nuk mund të sanonte mosplotësimin e një kërkese të detyrueshme të Dosjes së Tenderit. Parimi i ekonomicitetit dhe efikasitetit të përdorimit të fondeve publike duhet të zbatohet në harmoni me kërkesat e procedurës së prokurimit dhe nuk mund të interpretohet në atë mënyrë që Autoriteti Kontraktues të detyrohet të rekomandojë ofertën me çmimin më të ulët nëse ajo nuk i plotëson kërkesat e përcaktuara paraprakisht.

Andaj duke u bazuar në të gjitha konstatimet e mësipërme, eksperti vlerëson se pretendimi i Grupit të OE **"LAB OIL" SH.P.K. & N.T. "Fer Petroll" SH.P.K.**, lidhur me eliminimin e tij për mosplotësimin e Kërkesës nr. 9.1.4 të FDT-së dhe pretendimin për trajtim të pabarabartë në raport me OE të rekomanduar **"Petrol Company" SH.P.K.**, është **i pa bazuar.**

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **Agjencia Qendrore e Prokruimit**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **LAB-OIL SH.P.K.**

Bujar Kuçi